



Ne kuader te Eliminatoreve te Kupes se Botes skuadra Kombetare e Shqiperise ndeshjen e dyte ne grup do ta zhvilloje ne Tirane perballe Perfaqesueses se Hollandes. Sic dihet futbollistet hollandeze jane mjaft te njohura ne arenen Europiane dhe Boterore, ndersa vajzat tona kane nje eksperience mjaft te vogel ne te tilla ballafaqime. Gjithsesi trajneri Altin Rraklli ka besim tek skuadra e tij per nje performance me te mire. Ne ndeshjen e pare zyrtare ndaj Belgjikes, Shqiperia e femrave u mund me rezultatin 2-0. Tani synon nje rezultat pozitiv ne shtepi. Te enjten ne Qemal Stafa do te luhet Shqiperi-Hollande, ne oren 17:00 dhe hyrja do te jete falas ne pritje te nje perkrahje masive per vajzat futbolliste.